

Shkodër, 06.11.2023

Shume të dashur meshtarë dhe motra,

Duke uruar që puna dhe shërbimi juaj të shkojë sa më mirë, gjej rastin t'ju falendëroj edhe për përgjigen pozitive që vitin e kaluar i keni dhënë bamirësisë së Kishës duke treguar gatishmërinë tuaj bujare për lëmoshën e Ditës së Caritasit 2022. Jam i sigurt se edhe ju vetë vazhdoni të ndihmoni në forma të ndryshme në realitetet e famullive tuaja duke zbutur sadopak varfëritë e ndryshme në dioqezën tonë.

Në këtë linjë, Caritasi Dioqezan mundohet që në forma të ndryshme të jetë promotori dhe nxitësi i frysës së bamirësisë së Kishës. Kështu, falë bashkëpunimit tuaj dhe nxitjes së vazhdueshme të kësaj frysme, jemi të thirrur që të jetojmë dhe të shpallim porosinë e Shën Nënë Terezës duke ndihmuar të varfërit ndër më të varfër.

Këtë të **diele me 17 dhjetor i bie Dita e Caritasit**, njëherazi është edhe e diela e tretë e Kohës së Ardhjes, ose siç quhet ndryshe edhe e **Diela e gjëzimit**. Mendoj se, bamirësia ndaj të varfërvë kthehet në gjësim për të gjithë ata që i kanë humbur shpresat dhe që në këtë kohë të shenjtë ta gjejnë gjëzimin e vërtetë në dashurinë e Krishtit fëmijë.

Ju ftoj që në meshët që do të kremoni këtë të diele, t'i caktoni një vëmendje të veçantë

Ditës së Caritasit duke i nxitur besimtarët që ta hapin zemrën ndaj të varfërvë.

Ju kujtoj që lëmoshat e mbledhura në këtë ditë mund t'i dorëzoni tek zyrat e Caritasit në ditët në vazhdim.

Duke ju falënderuar edhe një herë për bashkëpunimin, Ius Zotin bashkë me ju që ardhja e Jezusit të sjellë gjësim në jetën e të varfërvë dhe në jetën tuaj.

Dom Gjovalin Simoni

Drejtor i Caritas Shkodër-Pult

